



Instituti i Kosovës për Drejtësi  
Kosovo Law Institute  
Kosovski Institut Pravde

21/2024



# DIMENSIONI GJINOR I KORRUPSIONIT

Autore: Arrita Reznici

Redaktorë: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) – Departamentit të Shtetit Amerikan, apo të National Endowment for Democracy (NED).

Implementuar nga:



Instituti i Kosovës për Drejtësi  
Kosovo Law Institute  
Kosovski Institut Pravde



Mbështetur nga:



Rreth IKD:

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD, Rr. Ilaz Agushi

Prishtinë

E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)

[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Dhjetor, 2024

Prishtinë, Republika e Kosovës

## Përmbajtja

1.	Përmbledhje ekzekutive .....	4
2.	Aspekte gjinore në luftën kundër korrupsionit .....	6
2.1.	Lidershipi i grave dhe zvogëlimi i korrupsionit.....	6
2.2.	Gratë si viktimë e korrupsionit .....	7
3.	Ndarja gjinore e pozitive udhëheqëse në Kosovë .....	7
3.1.	Presidenca .....	7
3.2.	Legjislativi .....	8
3.3.	Ekzekutivi .....	10
3.4.	Gjyqësori.....	11
4.	Qasja gjinore e luftës kundër korrupsionit.....	14
4.1.	Promovimi i transparencës.....	14
4.2.	Qeverisja etike .....	15
4.3.	Perceptimi i publikut dhe llogaridhënia.....	15
5.	Fuqizimi i grave në luftimin e korrupsionit .....	16
5.1.	Identifikimi dhe njohja e të gjitha formave të korrupsionit .....	16
5.2.	Rëndësia e masave afirmative.....	16
5.3.	Luftimi i stereotipeve gjinore.....	17
6.	Rekomandimet .....	18

## 1. Përmbledhje ekzekutive

Viteve të fundit, studime dhe shembuj nga jeta reale kanë vënë në dukje potencialin e grave lidere për të udhëhequr me integritet. Madje studime të shumta kishin edhe përfundime të qarta: me më shumë gra në pushtet, kishte më pak korrupsion. Kësisoj, integrimi i perspektivës gjinore po diskutohet gjithnjë e më shumë si një mjet për të luftuar korrupsionin. Por jo vetëm kaq, në përgjithësi duhet ditur se barazia gjinore luan një rol të rëndësishëm në uljen e korrupsionit. Arsyet përmenden në kontekste të ndryshme, por në përgjithësi gratë prioritojnë gjithëpërfshirjen, drejtësinë dhe nevojat e komuniteteve të marginalizuara, që mund të përktëhet në krijimin e politikave më etike dhe reduktimin e mundësive për shfrytëzim apo praktika korruptive.

Në përgjithësi shoqëritë me më shumë barazi gjinore priren të kenë institucione më të forta, qeverisje më të mirë dhe më pak tolerancë ndaj praktikave korruptive. Në Kosovë në anën tjetër, përkundër reformave ndër vite në përpjekje për avancimin e legjislacionit në fusha të ndryshme, megjithatë, kjo përpjekje mbetet vetëm gjysmake pa përfshirjen e plotë dhe kuptimplotë të grave, jo vetëm si pjesëmarrëse, por edhe si vendimmarrëse. Kësisoj, në vendin tonë duket se pozitat udhëheqëse janë të “uzurpuara” nga burrat, sepse në të gjitha shtyllat kryesore dominojnë ata.

Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës e deri më tani, Republika e Kosovës ka pasur gjithsej 5 presidentë, ndër të cilët, dy kanë qenë gra. Në pozita udhëheqëse të legjislacionit, deri më tani vetëm një herë ka pasur një grua që ka udhëhequr me Kuvendin dhe atë vetëm për një periudhë kohore prej nëntë muajsh. Ndërsa, si pjesë e kryesisë së kuvendit, në pesë legjislaturat e fundit, kanë dominuar dukshëm burrat, ku 19 nënkryetarë të Kuvendit kanë qenë burra dhe vetëm 5 kanë qenë gra. Përfaqësimi i grave në pozita udhëheqëse brenda ekzekutivit ende shënon nën-përfaqësim. Që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, Kosova në vazhdimësi është qeverisur nga kryeministra burra dhe asnjëherë nuk ka pasur kryeministre grua. Ndërsa, në tri qeveritë e fundit, ajo që shihet qartazi është se në përbërje të përgjithshme (ministra dhe zëvendëskryeministra) asnjëherë ndër këto vite, gratë nuk kanë qenë të përfaqësuara as sa gjysma e burrave në qeveri. As gjyqësori nuk qëndron më mirë. Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, Gjykata Supreme, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Oda e Avokatëve të Kosovës janë të gjitha të udhëhequra nga burra. Por jo vetëm kaq, edhe në udhëheqjen e gjykatave dhe prokurorive themelore në vend, dukshëm dominojnë burrat. Përderisa në udhëheqjen e gjykatave themelore, nga shtatë gjykatat themelore në vend kemi dy gra që shërbejnë si kryetare të gjykatave, për sa i përket prokurorive themelore situata është shumë më keq – asnjë grua nuk udhëheq me asnjë nga shtatë prokuroritë themelore në Kosovë. Njësoj, edhe kryetarët e Gjykatës së Apelit, Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Komerciale të Kosovës janë burra. Po ashtu edhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, Prokuroria e Apelit dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit – të gjitha udhëhiqen nga burrat. E vetmja pozitë udhëheqëse e besuar një gruaje – por jashtë sistemit të rregullt gjyqësor, përbën pozita e Kryetares së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Përfshirja e grave në pozita udhëheqëse jo vetëm që kontribuon në diversitetin e perspektivave në qeverisje, por është edhe një tregues i një demokracie të mirëfilltë. Kjo pabarazi e thellë duhet të ndryshohet në mënyrë që të kemi një sistem gjithëpërfshirës.

Përderisa lidhja mes grave dhe luftimit të korrupsionit paraqet disa dinamika interesante, për sa i përket situatës ku gratë janë viktimë e korrupsionit, atëherë mund të themi se të njëjtat përjetojnë pasojat në mënyrë të pabarabartë. Korrupsioni është i dëmshëm për barazinë gjinore dhe përbën një pengesë për gratë që të fitojnë qasje të plotë në të drejtat e tyre civile, sociale dhe ekonomike. Gratë janë më shumë në rrezik për zhvatje në ofrimin e shërbimeve publike dhe korrupsioni që përjetojnë gratë mund të ketë një aspekt të abuzimit seksual. Kjo formë e korrupsionit njihet si “sextortion”, që nënkupton shfrytëzimin seksual si formë e korrupsionit. Prandaj është e nevojshme që të rritet vetëdija tek zyrtarët publikë dhe tek shoqëria në përgjithësi për mënyrat unike në të cilat korrupsioni ndikon te gratë, përfshirë format e ndryshme si shfrytëzimi seksual. Në vendin tonë duket se ende mungon vetëdijesimi i duhur në njohjen dhe raportimin e kësaj forme të korrupsionit. Prandaj, trajtimi i këtij problemi kërkon më shumë sesa masa kundër korrupsionit. Kërkon një angazhim gjithëpërfshirës për fuqizimin e grave, promovimin e barazisë gjinore dhe krijimin e sistemeve gjithëpërfshirëse.

Kur mundësitë janë të barabarta për të gjithë, eliminohen barrierat e padukshme dhe kultivohet një kulturë të vërtetë të barazisë shoqërore. Si rezultat, shoqëritë me më shumë barazi gjinore priren të kenë institucione më të forta, qeverisje më të mirë dhe më pak tolerancë ndaj praktikave korruptive.

## 2. Aspekte gjinore në luftën kundër korrupsionit

### 2.1. Lidershipi i grave dhe zvogëlimi i korrupsionit

Roli i grave në udhëheqje përbën një faktor kritik për nxitjen e qeverisjes të bazuar në vlera dhe parime etike dhe llogaridhënese. Vitet e fundit, studime dhe shembuj nga jeta reale kanë vënë në dukje potencialin e grave lidere për të udhëhequr me integritet. Hulumtimet lidhur me gjininë dhe korrupsionin duket se fillojnë me disa studime të porositura nga Banka Botërore, të cilat raportuan korrelacione midis përqindjes së grave në pozita udhëheqëse në vende të ndryshme dhe masave kundër korrupsionit në ato vende. Përfundimi dukej i qartë: me më shumë gra në pushtet, kishte më pak korrupsion.<sup>1</sup> Tutje, ka studime që kanë gjetur se gratë në poste publike janë më të prira për të shmangur sjelljet e pahijshme.<sup>2</sup> Njëkohësisht edhe ka studime që përkrahin idenë se gratë shpesh ndëshkohen nga shoqëria shumë më ashpër se burrat për të njëjtat shkelje etike. Ndoshta sepse gratë në pozita udhëheqëse janë ende të nën-përfaqësuar dhe përbëjnë përjashtimin më shumë sesa rregull. Me pak fjalë, nëse pritet që lideret gra të jenë më pak të korruptueshme, do të ketë më shumë arsye që ato të jenë të tilla në të vërtetë, krahasuar me homologët e tyre burra, të cilët mund ta perceptojnë këtë pritshmëri si një pranueshmëri të heshtur ndaj sjelljes së tyre korruptive.<sup>3</sup> Si rezultat i gjetjeve të këtyre llojeve, integrimi i perspektivës gjinore po diskutohet gjithnjë e më shumë si një mjet për të luftuar korrupsionin.

Por jo vetëm kaq, në përgjithësi duhet ditur se barazia gjinore luan një rol të rëndësishëm në uljen e korrupsionit. Korniza ligjore e Kosovës në vazhdimësi i është nënshtruar reformave në përpjekje për avancimin e legjislacionit në fusha të ndryshme, megjithatë, kjo përpjekje mbetet vetëm gjysmake pa përfshirjen e plotë dhe kuptimplotë të grave, jo vetëm si pjesëmarrëse, por edhe si vendimmarrëse. Shoqëritë me më shumë barazi gjinore priren të kenë institucione më të forta, qeverisje më të mirë dhe më pak tolerancë ndaj praktikave korruptive.

Në përgjithësi gratë udhëheqëse kanë tendencë të sjellin perspektiva unike, ndjeshmëri më të madhe dhe qasje bashkëpunuese në udhëheqje, duke sfiduar strukturat tradicionale të pushtetit që mund të mundësojnë praktika korruptive. Kjo nënkupton se gratë prioritojnë gjithëpërfshirjen, drejtësinë dhe nevojat e komuniteteve të marginalizuara, që mund të përkthehet në krijimin e politikave më etike dhe reduktimin e mundësive për shfrytëzim apo praktika korruptive. Prania e grave në pozita udhëheqëse lidhet edhe me rritjen e transparencës dhe angazhimin më të madh ndaj drejtësisë sociale. E gjithë kjo bën që roli i grave të vlerësohet si vendimtar në krijimin e mjediseve ku korrupsioni e ka të vështirë të lulëzojë.

Kjo ndërthurje midis barazisë gjinore dhe përpjekjeve kundër korrupsionit nënvizon rëndësinë e fuqizimit të grave udhëheqëse për të kontribuar në qeverisjen etike. Pjesëmarrja e tyre nuk është thjesht simbolike, por thelbësore për riformësimin e sistemeve politike, ekonomike dhe sociale drejt një integriteti dhe llogaridhënie më të madhe.

---

<sup>1</sup> Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), “Koha është tani: Trajtimi i dimensioneve gjinore të korrupsionit”. 2020. fq. 12.

<sup>2</sup> Korrupsioni, Llogaridhënia dhe Gjinia, Andrew C. Eggers, Nick Vivyan and Markus Wagner, Janar 2018.

<sup>3</sup> Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), “Koha është tani: Trajtimi i dimensioneve gjinore të korrupsionit”. 2020. Fq. 29.

## 2.2. Gratë si viktimë e korrupsionit

Përderisa lidhja mes grave dhe luftimit të korrupsionit paraqet disa dinamika interesante, për sa i përket situatës ku gratë janë viktimë e korrupsionit, atëherë mund të themi se të njëjtat përjetojnë pasojat në mënyrë të pabarabartë.

Gratë janë viktimë e diskriminimit në forma të ndryshme – ligjore, politike, ekonomike dhe nga paragjykimet socio-kulturore. Prandaj, nuk është e habitshme që gratë janë veçanërisht të ndjeshme apo veçanërisht të prekura nga korrupsioni. Korrupsioni është i dëmshëm për barazinë gjinore dhe përbën një pengesë për gratë që të fitojnë qasje të plotë në të drejtat e tyre civile, sociale dhe ekonomike. Duhet cekur dy çështje të rëndësishme në këtë drejtim – e para, gratë janë më shumë në rrezik për zhvatje në ofrimin e shërbimeve publike dhe, së dyti, korrupsioni që përjetojnë gratë mund të ketë një aspekt të abuzimit seksual.<sup>4</sup>

Këto dy pika mund të ndërthuren në atë që njihet si “monedha gjinore e korrupsionit”. Kjo përbën situatat kur grave u kërkohen favore seksuale për të pasur qasje në shërbime që, në fakt, janë ndonjëherë edhe falas.<sup>5</sup> Kjo formë e korrupsionit njihet si “sextortion”, që nënkupton shfrytëzimin seksual si formë e korrupsionit. Megjithatë, ndikimi i korrupsionit te gratë nuk është i njëtrajtshëm. Faktorë si mosha, etnia, aftësia e kufizuar dhe statusi socio-ekonomik ndërthuren për të shtuar dobësitë e grupeve të caktuara të grave. Për shembull, gratë rurale dhe ato nga komunitetet e marginalizuara mund të përballen me pengesa edhe më të mëdha për të pasur qasje në drejtësi ose për të raportuar korrupsionin, për shkak të diskriminimit sistematik dhe izolimit gjeografik.

Në vendin tonë duket se ende mungon vetëdijesimi i duhur në njohjen dhe raportimin e kësaj forme të korrupsionit. Prandaj, trajtimi i këtij problemi kërkon më shumë sesa masa kundër korrupsionit. Kërkon një angazhim gjithëpërfshirës për fuqizimin e grave, promovimin e barazisë gjinore dhe krijimin e sistemeve gjithëpërfshirëse.

## 3. Ndarja gjinore e pozitive udhëheqëse në Kosovë

Në përgjithësi në Kosovë duket se pozitat udhëheqëse janë të “uzurpuara” nga burrat. Ata dominojnë në të gjitha shtyllat kryesore. Kapitulli në vijim jep një pasqyrë të viteve të fundit, situatës faktike dhe gjendjes së përgjithshme që përfshin shtyllat kryesore në vend: legjislativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin, e po ashtu edhe pozitën e Presidentit të vendit.

### 3.1. Presidenca

Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës.<sup>6</sup> Presidenti vepron gjithashtu si ndërmjetës në kohë krizash politike,


<sup>4</sup> Transparency International, “Rekomandime për Gratë kundër Korrupsionit në kuadër të Planeve të Veprimit të PQH”, 2020. Fq. 3.

<sup>5</sup> Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), “Koha është tani: Trajtimi i dimensioneve gjinore të korrupsionit”. 2020. fq. 12.

<sup>6</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 4.3.

duke nxitur dialogun midis partive politike dhe institucioneve. Si një figurë unifikuese, Presidenti përfaqëson unitetin e popullit, duke siguruar që vendi të funksionojë brenda kuadrit të Kushtetutës dhe ligjeve të tij.

Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës e deri më tani, Republika e Kosovës ka pasur gjithsej 5 presidentë. Në këtë pozitë, ndër vite, dy prej tyre kanë qenë gra.




**Grafika 1.** Numri i grave dhe burrave presidentë të Republikës së Kosovës ndër vite.

### 3.2. Legjislativi

Në pozita udhëheqëse të legjislativit, deri më tani vetëm një herë ka pasur një grua që ka udhëhequr me Kuvendin dhe atë vetëm për një periudhë kohore prej nëntë muajsh. Ndërsa, si pjesë e kryesisë së kuvendit, në pesë legjislaturat e fundit, kanë dominuar dukshëm burrat. Në secilën legjislaturë ka pasur 4 ose 5 nënkryetarë, nga të cilët në tërësi, 19 kanë qenë burra dhe vetëm 5 kanë qenë gra.






**Grafika 2. Numri i grave dhe burrave nënkryetar në Kuvendin e Republikës së Kosovës ndër vite.**

Për sa i përket pjesëmarrjes së deputetëve, në Kosovë është përcaktuar kuota gjinore në masën 30% për sa i përket përfshirjes së grave në lista zgjedhore. Në vitin 2010 kishte hyrë në fuqi ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për zgjedhje, i cili ndryshim përcaktonte se nëse pas ndarjes së vendeve të përcaktuara për kandidatët në listën e një subjekti politik, ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të ndarë për atë subjekt politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga kandidati i radhës i gjinisë pakicë në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%.<sup>7</sup> Për të qartësuar edhe më mirë këtë situatë, ishte kujdesur ligji i ri i miratuar në vitin 2023 – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (tutje: Ligji për Zgjedhjet) ka përcaktuar se në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30%) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30%) për qind janë femra; me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë.<sup>8</sup>

Kjo dispozitë konsiderohet si një masë afirmative për rritjen e përfaqësimit të grave në organin kryesor legjislativ në vend. Për shembull, në zgjedhjet më të fundit, gratë përbënin rreth 36% të organit legjislativ. Duhet shtuar po ashtu se në përgjithësi rastet e shumta të grave të përzgjedhura në pozitën e deputetes, kanë ardhur si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e votave të qytetarëve, pa nevojën e përdorimit të kuotës.

<sup>7</sup> Ligji Nr. 03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 8, par 2.

<sup>8</sup> Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 28.



**Grafika 3. Numri i grave deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës ndër vite.<sup>9</sup>**

Megjithatë përfaqësimi i grave në Kuvend ende mbetet larg prej asaj që ka përcaktuar Ligji për Barazinë Gjinore, i cili shkon një hap më tej duke përcaktuar që institucionet publike, përfshirë degën legjislative, që duhet të sigurojnë përfaqësim 50% të secilës gjini.<sup>10</sup>

### 3.3. Ekzekutivi

Përfaqësimi i grave në pozita udhëheqëse brenda ekzekutivit të Kosovës përkundër një rritje të lehtë të shënuar ndër vite, ende shënon nën-përfaqësim. Përkundër kuadrit ligjor si Ligji për Barazi Gjinore dhe politikave të ndryshme që promovojnë pjesëmarrjen e grave në masë më të madhe, gratë vazhdojnë të përballen me sfida të shumta në rrugën drejt përfaqësimit të barabartë në pozita të larta brenda ekzekutivit. Shkalla e përfaqësimit mbetet nën standardet e kërkuara nga ligjet ekzistuese dhe stereotipet gjinore vazhdojnë të jenë pengesë për pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të grave në qeverisje.


Që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, Kosova në vazhdimësi është qeverisur nga kryeministra burra dhe nuk ka pasur asnjëherë kryeministre grua.

Në vijim është paraqitur në mënyrë grafike përfaqësimi i grave në Qeveri, si ministre por edhe si zëvendëskryeministre në tri qeveritë e fundit. Ajo që shihet qartazi është se në përbërje të

<sup>9</sup> Të dhënat e marra nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ).

<sup>10</sup> Ligji nr. 05/1 -020 për Barazi Gjinore, neni 6, par. 8.

përgjithshme (ministra dhe zëvendëskryeministra) asnjëherë ndër këto vite, gratë nuk kanë qenë të përfaqësuara as sa gjysma e burrave në qeveri.




**Grafika 4. Numri i grave dhe burrave ministra dhe zv. kryeministra në Qeverinë e Republikës së Kosovës ndër vite.**

Përfshirja e grave në pozita udhëheqëse jo vetëm që kontribuon në diversitetin e perspektivave në qeverisje, por është edhe një tregues i një demokracie të mirëfilltë. Në këtë kontekst, analizimi i gjendjes aktuale, sfidave që përballen gratë në ekzekutivin e Kosovës dhe adresimi i tyre me qëllim të përmirësimit dhe rritjes së pjesëmarrjes së grave në këto pozita, është një hap i domosdoshëm.

### 3.4. Gjyqësori

Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, Gjykata Supreme, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Oda e Avokatëve të Kosovës janë të gjitha të udhëhequra nga burra. E vetmja pozitë udhëheqëse e besuar një gruaje – por jashtë sistemit të rregullt gjyqësor, përbën pozita e Kryetares së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.




**Grafika 5. Ndarja gjinore e pozitave udhëheqëse në Gjykatën Kushtetuese dhe sistemin e drejtësisë.**

Fakti se vetëm Gjykata Kushtetuese udhëhiqet nga një grua, kurse tërë sistemi i rregullt gjyqësor udhëhiqet nga burrat, bën që të përjashtohet kështu mundësia që gratë në mënyrë aktive të jenë pjesë e lidërshiptit apo politikbërjes dhe vendimmarrjes efektive në përmirësimin e gjendjes në gjyqësor, prokurori dhe avokati. Kjo pasqyron mungesë të theksuar të vullnetit për t'u besuar grave pozita udhëheqëse. Avancimi i të drejtave të grave nuk duhet të mbetet vetëm në nivelin e krijimit të kornizës ligjore apo politikave specifike, por duhet të shtrihet në zbatimin praktik të tyre dhe në ndryshimin e mendësisë që pozitat udhëheqëse janë “të rezervuara” për burrat.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) janë institucione të pavarura që funksionojnë si shtylla themelore të sistemit të drejtësisë dhe kanë rol të pazëvendësueshëm në garantimin e sundimit të ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve në Kosovë. Rregullimi dhe përbërja e këtyre dy institucioneve janë të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.<sup>1112</sup> Njësoj sikurse në pozitat udhëheqëse të këtyre dy institucioneve, në krye të të cilave kemi burra, edhe përbërja e të njëjtave dominohet nga burrat, ku KGJK nga 11 anëtarë, ka 8 burra dhe vetëm 3 gra. Në anën tjetër, KPK ka 10 burra dhe vetëm 2 gra anëtare të këtij këshilli.


<sup>11</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 108.

<sup>12</sup> Po aty, neni 110.



**Grafika 6. Ndarja gjinore e anëtarëve të KGJK-së dhe KPK-së.**

Por jo vetëm kaq, edhe në udhëheqjen e gjykatave dhe prokurorive themelore në vend, dukshëm dominojnë burrat. Përderisa në udhëheqjen e gjykatave themelore, nga shtatë gjykatat themelore në vend kemi dy gra që shërbejnë si kryetare të gjykatave, për sa i përket prokurorive themelore situata është shumë më keq – asnjë grua nuk udhëheq me asnjë nga shtatë prokuroritë themelore në Kosovë. Njësoj, edhe kryetarët e Gjykatës së Apelit, Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Komerciale të Kosovës janë burra. Po ashtu edhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), Prokuroria e Apelit dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit – të gjitha udhëhiqen nga burrat.



**Grafika 7. Ndarja gjinore e kryetarëve të gjykatave dhe kryeprokurorëve.**

Avokatura konsiderohet profesion i pavarur dhe është e përcaktuar si kategori kushtetuese.<sup>13</sup> Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK) përfaqëson institucionin thelbësor në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të avokatëve, në përmirësimin e standardeve profesionale dhe në garantimin e qasjes në drejtësi. Në historinë e këtij institucioni, që nga fillimi më 1974 e deri në vitin 2024, vetëm një grua ka shërbyer si kryetare e OAK-së.<sup>14</sup> Kjo situatë dëshmon edhe për një tjetër institucion thelbësor të drejtësisë që dominohet nga burrat.

Kjo pabarazi e thellë në sistemin e drejtësisë duhet të ndryshohet në mënyrë që të kemi një sistem të drejtësisë gjithëpërfshirës. Është thelbësore të sfidohen stereotipet gjinore dhe të ndryshohet ky mentalitet, çka kontribuon në ndërtimin e një shoqërie ku mundësitë janë të barabarta për të gjithë, duke eliminuar barrierat e padukshme dhe duke kultivuar një kulturë të vërtetë të barazisë shoqërore. Si rezultat, sistemi perceptohet si më i besueshëm, gjë që nxit ndjesitë që është sistem i drejtë dhe i paanshëm. Një drejtësi e kësaj forme, padyshim që rrit kërkesën për adresimin e të drejtave të qytetarëve, në veçanti grupeve të marginalizuara dhe bën që kërkesa për qasje në drejtësi vazhdimisht të jetë në rritje, duke sfiduar kështu hendekun midis dispozitave ligjore dhe përvojave jetësore, që ndikon tutje në avancimin e kornizës ligjore dhe aspekteve shoqërore, duke bërë kështu që të luftohet dhe minimizohet korrupsioni.

## 4. Qasja gjinore e luftës kundër korrupsionit

Barazia gjinore ka një rol të rëndësishëm në uljen e korrupsionit. Shoqëritë me më shumë barazi gjinore priren të kenë institucione më të forta, qeverisje më të mirë dhe më pak tolerancë ndaj praktikave korruptive. Ka mendime që thjesht konsiderojnë se institucionet funksionale, liberale, lejojnë pjesëmarrjen më të madhe të grave në vendimmarrje dhe në të njëjtën kohë çojnë në nivele më të ulëta të korrupsionit.<sup>15</sup>

Megjithatë ajo që dominon në përgjithësi në studimet e ndryshme, analizat e përgjithshme dhe praktikatat e caktuara botërore, janë disa pika të përbashkëta në atë që gratë lidere arrijnë të kontribuojnë në luftën kundër korrupsionit. Rrjedhimisht dhe ky kapitull i dedikohet disa prej atyre karakteristikave të lidërshiptit nga gratë, siç janë: promovimi i transparencës, qeverisja etike dhe llogaridhënia.

### 4.1. Promovimi i transparencës

Prania e grave në pozita udhëheqëse shpesh lidhet edhe me rritjen e transparencës dhe angazhimin më të madh ndaj drejtësisë sociale. Gratë lidere luajnë një rol kyç në luftimin e korrupsionit dhe promovimin e transparencës në shoqëri. Përfshirja e tyre në pozita udhëheqëse rrit nivelin e integritetit dhe përgjegjshmërisë në institucionet publike dhe private. Shumë studime tregojnë se gratë prioritojnë gjithëpërfshirjen, drejtësinë dhe nevojat e komuniteteve

---

<sup>13</sup> Po aty, neni 111.

<sup>14</sup> Shih linkun: <https://oak-ks.org/kryetari>.

<sup>15</sup> Hung-En Sung, "Gjinia më e drejtë, apo sistemi më i drejtë? Rishikimi i gjinisë dhe korrupsionit", dhjetor 2003, fq. 710.

të marginalizuara, që mund të përkthehet në krijimin e politikave më etike dhe reduktimin e mundësive për shfrytëzim apo praktika korruptive.

Në kontekstin e Kosovës, ku korrupsioni mbetet një sfidë serioze, roli i grave si lidere është thelbësor për ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe të barabartë. Nxitja e pjesëmarrjes së grave në politikë, administratë publike dhe sektorin privat, në veçanti duke u besuar atyre pozita udhëheqëse, jo vetëm që fuqizon demokracinë, por gjithashtu krijon mjedis ku korrupsioni e ka të vështirë të lulëzojë.

Përmes gjithëpërfshirjes, që njihet si një element i leadershipit të grave, ndikohet drejtpërdrejt në rritjen e transparencës. Kjo formë e udhëheqjes duke përfshirë konsultime gjithëpërfshirëse bën që të promovohen praktika më të qëndrueshme dhe më të ndershme. Kësisoj, edhe minimizohet mundësia e aferave korruptive.

## 4.2. Qeverisja etike

Gratë priren të kenë standarde më të larta të sjelljes etike, duke i kushtuar rëndësi të veçantë të mirës së përbashkët. Ndërsa, në biznes, gratë duket se janë më pak të prirura të paguajnë rryshfete.<sup>16</sup> Kjo ndërthurje midis barazisë gjinore dhe përpjekjeve kundër korrupsionit nënvizon rëndësinë e fuqizimit të grave udhëheqëse për të kontribuar në qeverisjen etike.

Krahas kësaj, rrjetet korruptive shpesh dominohen nga burra dhe përjashtojnë gratë nga pjesëmarrja. Prandaj, mund të supozohet se një rritje e numrit të grave në vendimmarrje mund të shpërbëjë rrjetet ekzistuese dhe, si rezultat, të ulë nivelin e korrupsionit. Meqenëse gratë kanë qenë kryesisht të përjashtuara nga pushteti dhe, rrjedhimisht, edhe nga rrjetet korruptive, ato kanë më shumë gjasa të kundërshtojnë sjelljet korruptive kur i hasin.<sup>17</sup>

Rrjedhimisht mund të konstatohet se leadershipi i grave ndihmon në ndryshimin e kulturës institucionale, duke vendosur standarde më të larta për etikën dhe përgjegjshmërinë.

## 4.3. Perceptimi i publikut dhe llogaridhënia

Llogaridhënia e liderëve në raport me qytetarët bën që të ketë harmonizim të veprimeve konkrete me parimet e drejtësisë dhe transparencës. Këto janë mjete të fuqishme që ndikojnë direkt në rolin e grave udhëheqëse në shoqëri, veçanërisht kur këto shfrytëzohen në luftën kundër korrupsionit. Gratë në pozita udhëheqëse shpesh perceptohen si më etike dhe transparente, duke krijuar një pritshmëri më të lartë për to. Ky perceptim jo vetëm që rritë besimin e publikut, por gjithashtu vendos një standard më të lartë, i cili vepron si një pengesë ndaj aferave korruptive.

Kësisoj, gratë udhëheqëse duke qenë të vetëdijshme për këto pritshmëri, motivohen të dëshmojnë llogaridhënie dhe kështu jo vetëm që luftojnë drejtpërdrejt korrupsionin, por edhe

---

<sup>16</sup> Për më shumë, shih linkun: <https://www.transparency.org/en/press/gender-and-corruption-are-women-less-corrupt>.

<sup>17</sup> Westminster Foundation for Democracy, “Kundër Korrupsioni dhe Gjinia: Roli i Pjesëmarrjes Politike të Grave”, janar 2022. fq. 12

transformojnë pritshmëritë shoqërore për lidërsipin, duke promovuar ndryshime sistematike afatgjata. Kjo nënkupton se përfaqësimi i grave në pozita udhëheqëse nuk është thjesht simbolik, por thelbësor për riformësimin e sistemeve politike, ekonomike dhe sociale drejt një integriteti dhe llogaridhënie më të madhe.

## 5. Fuqizimi i grave në luftimin e korrupsionit

Një studim i fundit konfirmon se mekanizmat përmes të cilëve gratë ulin nivelet e korrupsionit ndryshojnë gjithashtu në varësi të llojit të korrupsionit që trajtohet. Studimi tregon se përfshirja e grave ka ulur si “korrupsionin e vogël” ashtu edhe atë “të madh”, por për arsye shumë të ndryshme. Autorët argumentojnë, për shembull se gratë përqendrohen në sektorë që tradicionalisht janë të rëndësishëm për to dhe ulin korrupsionin e vogël në këta sektorë. Nga ana tjetër, korrupsioni i madh luftohet duke shpërbërë rrjetet e dominuara nga burrat dhe kështu pengojnë vazhdimësinë e korrupsionit.<sup>18</sup>

Në anën tjetër, përfshirja sa më e madhe e grave në procese vendimmarrëse bën që të sfidohen normat tradicionale dhe kontribuon në njohjen më të gjerë shoqërore të aftësive të grave në pozita udhëheqëse, duke përfshirë edhe në luftimin e korrupsionit.

### 5.1. Identifikimi dhe njohja e të gjitha formave të korrupsionit

Gurthemel për luftimin e një fenomeni të përgjithshëm përbën identifikimi i problematikave kyçe dhe njohja e koncepteve bazike përkitazi me atë fenomen. Në këtë drejtim është kyçe që të njihen të gjitha format e korrupsionit, përfshirë edhe shfrytëzimin seksual (apo “sextortion”).

Në vendin tonë duket se ende mungon vetëdijësimi i duhur në njohjen dhe raportimin e kësaj forme të korrupsionit. Prandaj, trajtimi i këtij problemi kërkon më shumë sesa masa kundër korrupsionit. Kërkon një angazhim gjithëpërfshirës për fuqizimin e grave, promovimin e barazisë gjinore dhe krijimin e sistemeve gjithëpërfshirëse, duke ndikuar në reduktimin e stigmës dhe inkurajimin e viktimave për raportimin e rasteve të tilla.

Një hap i parë në këtë drejtim përbën rritja e vetëdijes në shoqëri për këtë fenomen dhe praktika të tilla, për të vazhduar tutje me përfshirjen e perspektivës gjinore në strategjinë dhe politikën e përgjithshme kundër korrupsionit. E gjithë kjo hap rrugë për adresimin e nevojave të grave dhe luftimin e fenomeneve të keqtrajtimit të të njëjtave kur janë viktimë e korrupsionit.

### 5.2. Rëndësia e masave afirmative

Masat afirmative luajnë një rol thelbësor në promovimin e barazisë gjinore dhe sigurimin e përfshirjes së grave në pozita udhëheqëse dhe vendimmarrëse. Këto masa janë veçanërisht të rëndësishme në shoqëritë ku barrierat sistematike, normat kulturore dhe praktikën institucionale historikisht kanë kufizuar pjesëmarrjen e grave në qeverisje dhe jetën publike.

---

<sup>18</sup> Po aty, fq. 18



Kuotat kanë qenë një masë e mirë për të rritur përfaqësimin e grave dhe nëse ndiqet argumenti se një numër më i madh grash në pozita udhëheqëse ul korrupsionin, mund të pritët që ato të jenë – të paktën indirekt – një mjet për të frenuar korrupsionin.<sup>19</sup> Duke garantuar një nivel minimal të pjesëmarrjes, këto masa sigurojnë që gratë të kenë qasje në mundësi për të ndikuar në politikat dhe vendimet, përfshirë ato që synojnë luftimin e korrupsionit. Megjithatë, duhet pasur parasysh që në Kosovë, Ligji për Barazinë Gjinore ka paraparë pjesëmarrjen e grave në masë më të madhe sesa që parashohin kuotat, duke përcaktuar përfaqësim të barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse.<sup>20</sup>

Gjithsesi, masat afirmative hapin rrugën për ndryshime sistemike afatgjata. Ato sigurojnë që zërat e grave të dëgjohen në krijimin e ligjeve, politikave dhe strategjive, përfshirë ato që kanë në fokus luftimin e korrupsionit. Kjo mundëson që institucionet të reflektojnë diversitetin gjinor, duke i bërë ato më të balancuara dhe më të afta për të adresuar nevojat e të gjithë qytetarëve.

### 5.3. Luftimi i stereotipeve gjinore

Stereotipet gjinore janë një pikëpamje e përgjithësuar ose një paragjykim rreth attributeve, karakteristikave ose roleve që gratë dhe burrat kanë ose duhet të kenë.<sup>21</sup> Të tilla paragjykime kufizojnë potencialin individual, por gjithashtu jetësojnë pabarazitë strukturore. Ballafaqimi dhe luftimi i këtyre stereotipeve mund të jetë një strategji e fuqishme për të adresuar korrupsionin.

Në përgjithësi, stereotipet gjinore karakterizohen me një kulturë heshtjeje dhe tolerance ndaj praktikave joetike. Kjo bën që në shumë raste, gratë dhe grupet e marginalizuara të dekurajohen nga raportimi i korrupsionit për shkak të frikës nga hakmarrja ose perceptimi i publikut. Kësisoj luftimi i stereotipeve dhe promovimi i barazisë gjinore mund të krijojë mjedis më të sigurt për të gjithë, ku korrupsioni ka më pak gjasa të kalojë pa u raportuar. Nga një perspektivë globale, vendet nordike luftojnë në mënyrë aktive stereotipet gjinore dhe vazhdimisht shënojnë nivelet më të ulëta të korrupsionit në botë, duke bërë kështu të mundur edhe lidhjen midis barazisë gjinore dhe transparencës.

---

<sup>19</sup> Po aty, fq. 20.

<sup>20</sup> Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, neni 6.8.

<sup>21</sup> OHCHR, “Stereotipizimi Gjinor dhe të Drejtat e Grave për Barazi Gjinore”. Për më shumë, shih linkun në vijim: <https://www.ohchr.org/en/women/gender-stereotyping>.

## 6. Rekomandimet

1. Institucionet ligjbërëse dhe ligjzbatuese të angazhohen maksimalisht dhe vazhdimisht për fuqizimin e grave, promovimin e barazisë gjinore dhe krijimin e sistemeve gjithëpërfshirëse, në mënyrë që ta përdorin lidhshkrimin e grave si formë për luftimin e korrupsionit.
2. Të rritet vetëdija tek zyrtarët publikë dhe tek shoqëria në përgjithësi për mënyrat unike në të cilat korrupsioni ndikon te gratë, përfshirë format e ndryshme si shfrytëzimi seksual (“sextortion”).
3. Të fillojë debati institucional në lidhje me nxjerrjen e masave ligjore dhe administrative që trajtojnë format gjinore të korrupsionit, përfshirë kërkesat për favore seksuale për qasje në shërbime.
4. Zyra e Kryeministrit dhe Qeveria e Kosovës të sigurohen që Strategjia kombëtare kundër Korrupsionit të përmbajë aktivitetet e planifikuara nën perspektivën gjinore.